ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2018-2025

Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike Tiranë

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2018-2025) 10
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025) 17
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2025) 18
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2018-2025) 18
Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2025) 24
Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2025) 26
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2025) 26
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2025) 27
Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2025) 30
Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2018-2025) 31
Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025) 33
Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2018-2025) 34
Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025) 35
Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2025) 37

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 10
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 11
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025) 11
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025) 12
Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2025) 12
Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2018-2025) 13
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 14
Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 14
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2025) 15
Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2025) 16
Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025) 16
Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 19
Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2018-2025) 20
Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 20
Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025) 21
Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2018-2025) 22
Figura 17: Madhësia e kompanisë (2018-2025) 23
Figura 18: Lloji i kontratës (2018-2025) 23
Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2025) 24
Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025) 25
Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2025) 27

Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2025) 28
Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025) 29
Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2018-2025) 29
Figura 25: Papunësia ndër vite (2018-2025) 30
Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025) 31
Figura 27: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025) 32
Figura 28: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2025) 33
Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025) 34
Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe e së njëjtës shkollë sipas gjinisë 2025 36

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3
Lista e figurave 3
Gjetjet kryesore 6
Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 8
Të diplomuarit 2018-2025 10
Analiza e rezultateve 12
Statusi i punësimit 12
Lidhja e punës me fushën e arsimit 15
Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 18
Viti i diplomimit 18
Viti i diplomimit 18
Niveli i pagave 19
Kushtet e punës 22
Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 24
Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 25
Mënyrat e gjetjes së punës së parë 26
Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 27
Të diplomuarit pa punë 30
Propozimet për përmirësim në shkollë 34
Planet për të ardhmen 36

Gjetjet kryesore

Ky raport paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i tetë brezave të të diplomuarve të Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë (SHTET), duke filluar me brezin e nxënësve të diplomuar në vitin 2018.

- Në vitin 2025, 38% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit.
- Norma e papunësisë për të diplomuarit e vitit 2025 ka qenë 19%. Mesatarisht, gjatë 2018-2024, 17% e të diplomuarve kanë qenë të papunë. Në këtë kontekst, vërehet një rritje e papunësisë për vitin 2025 me 2 pikë përqindje. 50% e të diplomuarve të papunë të vitit 2024 ishin në kërkim të një pune.
- Në vitin 2025, i diplomuari i vetëm në drejtimin Administrim zyre është përgjigjur dhe ai është i punësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 64% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes ishin të punësuar një vit pas diplomimit, 16% ishin të papunë dhe 19% ishin student/kursantë. Nga 3 të diplomuarit në Sipërmarrje e agjencisë turistike 2 prej tyre janë të punësuar ndërsa 1 është student/kursant. Nga ana tjetër nga të diplomuarit në Tekstil- konfeksion 47% e tyre janë të punësuar, 33% janë të papunë dhe 20% janë student/kursant një vit pas diplomimit.
- Të disagreguara sipas gjinisë të dhënat mbi statusin e punësimit një vit pas diplomimit të dhënat tregojnë se përkatësisht 53% e vajzave dhe 73% e djemve janë të punësuar (vetë-punësuar) një vit pas diplomimit. Ndërkohë, të papunë janë përkatësisht 22% e vajzave dhe 14% e djemve, dhe studimet e mëtejshme i ndjekin 24% e vajzave dhe 14% e djemve.
- 47% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit. Përkatësisht, 50% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes janë të punësuar në profesion. Në drejtimin Tekstil- Konfeksion për vitin 2025 14% e të diplomuarve në këtë drejtim janë përgjigjur se janë të punësuar në profesion. Për sa i përket të 2 diplomuarve në Sipërmarrje e agjencisë turistike janë përgjigjur që të dy janë të punësuar në profesion.
- 54% e të gjurmuarve pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit në vendin e punës “shumë/jashtëzakonisht shumë”, duke shënuar një rritje e konsiderueshme me 23 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (31%).
- Për vitin 2025, shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është: 33% merr pagë deri në 50,00 Lekë, 13% pagë 50,001 – 60, 000 lekë, 24% paguhen 60,001 – 80, 000 lekë, 15% paguhen 80,001 – 95,000 lekë, 4% paguhen 95,001 – 120,000 lekë dhe 11% paguhen më shumë se 120,001 lekë.
- 87% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit dhe 4% 1 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, përkatësisht 2% e kanë gjetur punën 3 – 6 muaj pas diplomimit, 4% 6 - 9 muaj pas diplomimit dhe 2% kanë arritur të gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit.
- Për të tetë brezat e gjurmuar, mënyra mbizotëruese e gjetjes së punës së parë është nga njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë. Përkatësisht, 50% e të diplomuarve gjatë vitit 2025, pohojnë se kanë gjetur punë nga njohjet personale, me një rënie prej 6 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (56%). Ndërkohë, 17% pohojnë se e kanë gjetur punën nga

njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta me një rritje prej 10 pikësh përqindje nga mesatarja 2018-2024 (27%). Gjithashtu 20% pohojnë që kanë gjetur punën nga praktika profesionale në biznes me një rritje prej 17 pikësh përqindje nga mesatarja 2018-2024 (3%).


- 74% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Përkatësisht 28% e të diplomuarve në vitin 2025 janë shprehur se ndjehen "të sigurt", me një rënie prej 13 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (41%) dhe 46% janë shprehur se ndjehen "shumë të sigurt" me një rritje prej 24 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (22%). Ndërkaq, 11% e të diplomuarve ndjehen "shumë të pasigurt" me një rritje 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (5%) dhe 2% njehen "të pasigurt" me një ulje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (7%).
- Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 78% e të diplomuarve të gjurmuar në vitin 2025 janë shprehur se ndjeheshin të "kënaqur" ose "shumë të kënaqur" dhe 11% kanë shprehur se ndjeheshin të "pakënaqur" dhe "shumë të pakënaqur".
- Sipas rezultateve të të diplomuarve në vitin 2024, të gjurmuarit vlerësojnë se çdo aspekt i shkollës ka nevojë për përmirësim "shumë/jashtëzakonisht shumë". Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësim praktikave në biznes 67% (me një rritje prej 14 pikë përqindje me mesataren e viteve 2018-2024 (53%), përmirësim të bashkëpunimi me bizneset, 63% (me një rritje me 11 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2024 (52%). Për më tepër, kërkohet përmirësimi i këshillimit në karrierë (60%), bashkëpunimi me zyrat e punës (60%) dhe praktika në shkollë (53%).
- Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimeve të mëtejshme 51% e të diplomuarve në vitin 2025 shpresojnë të kenë filluar një biznes të tyre. Këtu, vërehet një rritje me 8 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (34%). Ndërkohë, 35% kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që të lidhet me fushën e tyre të studimit. Mesatarisht, 2018-2024, 47% e të diplomuarve kanë shprehur dëshirën për të gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit duke vënë re një rënie me 8 pikë përqindje. Për më tepër 21% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se kanë dëshirë të ndjekin studime të mëtejshme. Këtu vërehet një rënie me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (27%). Ndërkohë, për vitin 2025, vërehet një ulje prej 7 pikë përqindje e të diplomuarve të cilët dëshirojnë të kenë emigruar jashtë vendit (19% mesatarja 2018-2024).

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, Shkolla Teknike Ekonomike Tiranë, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit 'Aftësi për Punë'.

Ky raport përmbledhës pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i **tetë brezave me të diplomuar** të Shkollës Teknike Ekonomike Tiranë.

Të diplomuarit 2018-2025


Në vitin shkollor 2023-2024, në Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë (SHTET), u diplomuan 116 nxënës (shiko tabelën 1), 18 nxënës më pak së në vitin 2023-2024. Nga të diplomuarit e vitit 2024-2025 u gjurmuan 86 nxënës ose 74% e të diplomuarve.

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2018-2025)

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2017-2018	200	114	57%
2018-2019	260	180	69%
2019-2020	237	152	64%
2020-2021	229	80	35%
2021-2022	211	149	71%
2022-2023	149	108	72%
2023-2024	134	81	62%
2024-2025	**116**	**86**	**74%**

Shumica e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin gjinisë femërore 57% (N=49). Ndërkohë, 43% (N=37) i përkasin gjinisë mashkullore (shiko figurën 1).

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=86

Figura 2 paraqet shpërndarjen e të gjurmuarve sipas drejtimeve që ofron shkolla. Në vitin 2024, 78% e të diplomuarve të gjurmuar i përkasin drejtimit Ekonomi-Biznes dhe 17% në drejtimit Tekstil-

Konfeksione, 4% në drejtimin Sipërmarrje e agjencisë turistike dhe vetëm 1 % (N=1) në drejtimin Administrim zyre.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=86

Të pyetur lidhur me vendbanimin, 98% e të diplomuarve të gjurmuar u përgjigjën se jetonin në Shqipëri dhe 2% jashtë vendit. Sikurse vërehet nga figura 2, numri i të diplomuarve që jetojnë jashtë vendit nuk ka pësuar ndryshime të qenësishme gjatë pesë viteve të fundit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2020-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=86).

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit

Sipas rezultateve të brezit të fundit të të gjurmuarve (2024-2025), nga një total prej 86 të anketuarish 30% (N=26) ishin të punësuar një vit pas diplomimit (shiko figurë 4), 8% (N=7) ishin të vetëpunësuar, 23% (N=20) ishin të punësuar por edhe studionin në të njëjtën kohë, 20% (N=17) ishin student/kursant. Ndërkohë, të papunë ishin 19% (N=16) e të anketuarve.


Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=86

Për vitin 2025, rezultatet tregojnë se 62% e të diplomuarve të gjurmuar (shiko figurën 5) ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit. Viti 2025 shënon një rritje të punësimit në krahasim me vitin paraardhës. Megjithatë, duhet theksuar se në vitin 2025, shkolla ka diplomuar 18 nxënës më pak se në vitin 2024 (referohu tabelës 1). Mesatarja e punësimit për të tetë brezat e gjurmuar (2018-2025) është 54%, duke e krahasuar me këtë përqindje kemi 8 pikë përqindje rritje. Gjithsesi mesatarisht pak më shumë se gjysma e të diplomuarve përfshihen në tregun e punës një vit pas diplomimit. Norma e papunësisë për të diplomuarit e vitit 2025 ka qenë 19%. Mesatarisht, 17% e të diplomuarve kanë qenë të papunë në vitet 2018-2025. Ndërkohë, mesatarisht 29% e të diplomuarve (2018-2025) janë student/kursant një vit pas diplomimit. Sikurse vërehet edhe nga figura 5 numri i të diplomuarve të cilët janë student/kursant një vit pas diplomimit për vitin 2025 ka ardhur duke u ulur ndër vite , dhe duke shënuar 20%.


Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=114); **2019** (N=180); **2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=86).

Të anketuarit që janë shprehur se janë në marrëdhënie pune janë pyetur më tej nëse janë të punësuar apo të vetëpunësuar. Për vitin 2025, 30% e të diplomuarve të gjurmuar janë të punësuar dhe 8% janë të vetëpunësuar (shiko figurën 6). Mesatarisht, gjatë viteve 2018-2024, 27% e të diplomuarve kanë qenë të punësuar dhe 6% të vetëpunësuar.


Figura 6: Punësimi përkundrejt vetë-punësimit (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=114); **2019** (N=180); **2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=86).

Në figurën 7 jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve të ofruara nga shkolla. Sikurse vihet re, i diplomuari i vetëm në drejtimin Administrim zyre është përgjigjur dhe ai është i punësuar një vit pas diplomimit. Ndërkohë, 64% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes ishin të punësuar një vit pas diplomimit, 16% ishin të papunë dhe 19% ishin student/kursantë. Nga 3 të diplomuarit në Sipërmarrje e agjencisë turistike 2 prej tyre janë të punësuar ndërsa 1 është student/kursant. Nga ana tjetër nga të diplomuarit në Tekstil- konfeksion 47% e tyre janë të punësuar, 33% janë të papunë dhe 20% janë student/kursant një vit pas diplomimit.


Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **TK** (N=15), **EB** (N=67), **AZ** (N=1), **SAT** (N=3).

Të disagreguara sipas gjinisë (shih figurën 8), të dhënat mbi statusin e punësimit një vit pas diplomimit jepen në figurën 8. Të dhënat tregojnë se përkatësisht 53% e vajzave dhe 73% e djemve janë të punësuar (vetë-punësuar) një vit pas diplomimit. Ndërkohë, të papunë janë përkatësisht 22% e vajzave dhe 14% e djemve, dhe studimet e mëtejshme i ndjekin 24% e vajzave dhe 14% e djemve.

Figura 8: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=37); **F** (N=49)

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 47% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën pozitivisht. Mesatarisht, përgjatë viteve 2018-2025 40% e të diplomuarve kanë pohuar se puna që bëjnë lidhet me fushën e tyre të arsimit.


Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=29); **2019** (N=81); **2020** (N=91); **2021** (N=42); **2022** (N=90); **2023** (N=44), **2024** (N=40), **2025** (N=53).

Nëse analizojmë lidhjen e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (shiko figurën 10), vërehet se mesatarisht (2020-2025) 42% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes dhe janë të punësuar në profesion dhe 14% e të diplomuarve në Tekstil- Konfeksion. Krahasuar me vitin 2024, të dhënat e të diplomuarve në vitin 2025 tregojnë një rritjen me 24 pikë përqindje të punësimin të lidhur me fushën e arsimit për të diplomuarit në Ekonomi-Biznes. Në drejtimin Tekstil- Konfeksion për vitin 2025 14% e të diplomuarve në këtë drejtim janë përgjigjur se janë të punësuar në profesion. Për sa i përket të 2 diplomuarve në Sipërmarrje e agjencisë turistike janë përgjigjur që të dy janë të punësuar në profesion.


Figura 10: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2020**: N_{EB}=82, N_{TK}=9; **Baza 2021**: N_{EB}=37, N_{TK}=5; **Baza 2022:** N_{EB}=83, N_{TK}=7; **Baza 2023:** N_{EB}=61, N_{TK}=8, **Baza 2024:** N_{EB}=29, N_{TK}=1, **Baza 2025:** N_{EB}=42, N_{TK}=7, Nsat=2.

Të ndara sipas gjinisë, të dhënat tregojnë se 33% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore dhe 56% e të diplomuarave të gjinisë femërore bëjnë një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit.

Figura 11: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_M=21; N_F=25

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), të diplomuarit e vitit 2025 përmendin dy arsye kryesore: (i) paga ose kushtet më të mira që ofron puna aktuale (40% në 2025, krahasuar me mesataren prej 24% për periudhën 2018–2024) dhe (ii) pamundësia për të gjetur një punë që lidhet me studimet (32% në 2025, krahasuar me mesataren prej 56% për periudhën 2018–2024). Arsyet e tjera përfshijnë kategorinë "Tjetër" (16%), mungesën e dëshirës për të punuar në fushën e studimeve (8%) dhe mungesën e ofertave të punës në këtë fushë në rajon (4%).

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Nuk gjeta një vend punë që lidhet me studimet e mia	62%	62%	63%	55%	50%	55%	47%	**32%**
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	0%	11%	6%	5%	9%	9%	0%	**8%**
Nuk ka oferta pune në fushën time në rajon	15%	14%	4%	5%	6%	7%	10%	**4%**
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	8%	14%	23%	25%	31%	27%	40%	**40%**
Tjetër	15%	0%	4%	10%	4%	2%	3%	**16%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=13); **2019** (N=37); **2020** (N=52); **2021** (N=20); **2022** (N=54); **2023** (N=44), **2024** (N=30), **2025** (N=25).

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet e gjurmimit të të diplomuarve në vitin 2025 tregojnë se njohuritë përdoren "shumë/jashtëzakonisht shumë" nga 54% e të gjurmuarve. Në këtë aspekt vihet re një rritje e konsiderueshme me 23 pikë përqindje në krahasim me vitin e mëparshëm (31%).

Ndërkohë, 15% e të diplomuarve të gjurmuar janë përgjigjur se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara gjatë studimeve. Mesatarja për këtë kategori për vitet 2018-2024 ka qenë 21%. Pra, kemi për vitin 2025 një ulje me 7 pikë përqindje të numrit të të diplomuarve të cilët pohojnë se i përdorin "aspak" njohuritë e fituara në shkollë në vendin e punës. Ndërsa kategoria e atyre që janë përgjigjur se i përdorin "disi" njohuritë, për vitin 2024 është 34%, ku vihet re një rritje me 4 pikë përqindje 30% në krahasim me mesataren e viteve 2018-2024.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2018-2025)

Viti i diplomimit	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2018	24%	28%	28%	17%	3%
2019	30%	6%	24%	24%	15%
2020	34%	16%	19%	13%	18%
2021	19%	12%	40%	21%	7%
2022	20%	24%	26%	17%	13%
2023	18%	16%	27%	24%	15%
2024	4%	17%	49%	21%	9%
2025	**15%**	**8%**	**34%**	**21%**	**33%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=29); **2019** (N=94); **2020** (N=91); **2021** (N=42); **2022** (N=90); **2023** (N=74), **2024** (N=47), **2025** (N=53).

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 44% e të diplomuarve në vitin 2025 e vlerësojnë lidhjen e pozicionit të punës me studimet e kryera me "shumë/jashtëzakonisht shumë". Nga ana tjetër, 34% e vlerësojnë me "pak/aspak" lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimit. Mesatarisht, 27% e të diplomuarve në vitet 2018-2025 e vlerësojnë lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve "shumë/jashtëzakonisht shumë" dhe 47% me "pak/aspak".

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2018-2025)

Viti i diplomimit	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2018	34%	21%	28%	14%	3%
2019	31%	13%	26%	19%	12%


2020	36%	22%	14%	11%	16%
2021	31%	21%	33%	7%	7%
2022	29%	18%	30%	10%	13%
2023	24%	19%	24%	19%	14%
2024	13%	28%	32%	17%	11%
2025	**23%**	**11%**	**23%**	**23%**	**21%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=29); **2019** (N=94); **2020** (N=91); **2021** (N=42); **2022** (N=90); **2023** (N=74), **2024** (N=47), **2025** (N=53).

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, për vitin 2025 (shiko figurën 12), shpërndarja e të diplomuarve sipas nivelit të pagave është:33% merr pagë deri në 50,00 Lekë, 13% pagë 50,001 – 60, 000 lekë, 24% paguhen 60,001 – 80, 000 lekë, 15% paguhen 80,001 – 95,000 lekë, 4% paguhen 95,001 – 120,000 lekë dhe 11% paguhen më shumë se 120,001 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=46

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko figurën 13), pasqyron një përmirësim të nivelit të pagave të të diplomuarve. Asnjë të diplomuarve të gjurmuar në vitin 2025 marrin një pagë më të ulët se paga 35,000 Lekë. Gjithashtu kemi rënie në përqindjen e të gjurmuarve të cilët marrin një pagë 35,001 – 50,000 lekë dhe për vitin 2025 kemi arritur në 32% ku vihet re një rënie me 21 pikë përqindje nga një vit më parë. Nga ana tjetër, është rritur përqindja e të diplomuarve që kanë një pagë 50,001 - 65,00 lekë (11% mesatarja e viteve 2018-2024, 13% në 2025). Ndërkohë, është rritur me 4 pikë

përqindje numri i të diplomuarve të cilët marrin një pagë 65,001 – 80,000 lekë duke arritur 23% në krahasim me mesataren e viteve 2018-2024 e cila është 6%. Për më tepër, 32% e të diplomuarve në 2025 marrin më shumë se 80,001 lekë, me një rritje me 20 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (12%).


Figura 13: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=29); **2019** (N=81); **2020** (N=91); **2021** (N=42); **2022** (N=90); **2023** (N=67), **2024** (N=47), **2025** (N=46).

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimeve (shiko figurën 14), të diplomuarit në Ekonomi-Biznes kanë një shpërndarje më të gjerë të pagave: 28,9% paguhen deri në 50,000 lekë dhe 23,7% marrin 60,001-80,000 lekë. Ndërkohë, 15,8% paguhen 80,001-95,000 lekë, nga 13,2% marrin përkatësisht 50,001–60,000 lekë dhe mbi 120,000 lekë, ndërsa 5,3% paguhen 95,001–120,000 lekë. Në drejtimin Tekstil-Konfeksione, nga 33,3% paguhen përkatësisht deri në 50,000 lekë dhe 60,001–80,000 lekë, ndërsa nga 16,7% marrin përkatësisht 50,001-60,000 lekë dhe 80,001-95,000 lekë. Të gjithë të diplomuarit e drejtimit Sipërmarrje e Agjencisë Turistike që iu përgjigjën kësaj pyetjeje paguhen deri në 50,000 lekë.


Figura 14: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_{EB}=38; N_{TK}=6, **NSip**=2

Të dhënat e disagreguara sipas gjinisë (figura 15) tregojnë se 44,0% e vajzave dhe 19,0% e djemve marrin një pagë deri në 50,000 lekë. Në intervalin 50,001–60,000 lekë përfshihen 20,0% e vajzave dhe 4,8% e djemve, ndërsa 60,001–80,000 lekë marrin 20,0% e vajzave dhe 28,6% e djemve. Dallimi është më i theksuar në intervalin 80,001–95,000 lekë, ku përfshihen 28,6% e djemve dhe 4,0% e vajzave. Ndërkohë, 4,8% e djemve dhe 4,0% e vajzave paguhen 95,001–120,000 lekë, ndërsa 14,3% e djemve dhe 8,0% e vajzave marrin mbi 120,000 lekë.

Figura 15: Niveli i pagave sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_M=21; N_F=25.

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës (me kohë të plotë apo të pjesshme), për të gjashtë brezat e gjurmuar vërehet që mbizotëron punësimi me kohë të plotë. Mesatarisht, 73% e të diplomuarve (2018-2025) punojnë me kohë të plotë një vit pas diplomimit. Përqindjen më të ulët të punësimit me kohë të plotë e kanë pasur të diplomuarit e vitit 2021 me 63% (shiko figurën 16). Ndërkohë, mesatarisht 21% e të diplomuarve 2018-2025 punojnë me kohë të pjesshme. Për sa i përket të diplomuarve që punojnë me kohë të plotë por sezonale për 2025 përqindja është 4%.


Figura 16: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=21); **2019** (N=70); **2020** (N=80); **2021** (N=38); **2022** (N=82); **2023** (N=71), **2024** (N=40), **2025** (N=46).

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 17), në brezin e fundit të të gjurmuarve (2025) vërehet se 35% e të diplomuarve punojnë në kompani me 10-49 punonjës me një rritje prej 15 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (20%), 33% punojnë në kompani me më shumë se 50 punonjës me një rritje me 3 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (30%), 26% e të diplomuarve punojnë në kompani me 1-4 punonjës me një rritje prej 4 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (22%) dhe 7% punojnë në kompani me 5-9 punonjës me të njëjtën përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (7%).


Figura 17: Madhësia e kompanisë (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=21); **2019** (N=70); **2020** (N=80); **2021** (N=38); **2022** (N=82); **2023** (N=71), **2024** (N=40), **2025** (N=46).

Në vitin 2025, 72% e të diplomuarve kanë një kontratë pune me punëdhënësin e tyre (shiko figurën 18). Nga ku, 46% kanë një kontratë pune me afat të pacaktuar dhe 26% me afat të caktuar. Ndërkohë, 24% nuk kanë një kontratë, ndonëse numri i këtyre të fundit mbetet i lartë, vërehet një përmirësim me 13 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 ku 37% e të diplomuarve nuk kishin një kontratë pune me punëdhënësin. Nga ana tjetër në 2025 4% e të diplomuarve po bëjnë praktikën.

Figura 18: Lloji i kontratës (2018-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë

është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=20); **2019** (N=70); **2020** (N=80); **2021** (N=38); **2022** (N=82); **2023** (N=71), **2024** (N=40), **2025** (N=46).

Sipas rezultateve të gjurmimit të të tetë brezave, mesatarisht 85% e të diplomuarve të punësuar deklarojnë se iu paguhen kontributet e detyrueshme nga ana e punëdhënësit (shiko figurën 19). Ndërkohë, mesatarisht 11% deklarojnë se nuk iu paguhen sigurimet nga punëdhënësi dhe vetëm 4% shprehen se nuk kanë informacion nëse iu paguhen apo jo sigurimet.

Figura 19: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=21); **2019;** (N=70); **2020** (N=80); **2021** (N=38); **2022** (N=82); **2023** (N=71), **2024** (N=40), **2025** (N=46).

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës, 74% e të diplomuarve në vitin 2025 u shprehën se ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt" (shiko tabelën 5). Përkatësisht 28% e të diplomuarve në vitin 2025 janë shprehur se ndjehen "të sigurt", me një rënie prej 13 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (41%) dhe 46% janë shprehur se ndjehen "shumë të sigurt" me një rritje prej 24 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (22%). Ndërkaq, 11% e të diplomuarve ndjehen "shumë të pasigurt" me një rritje 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (5%) dhe 2% njehen "të pasigurt" me një ulje me 5 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (7%).

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 78% e të diplomuarve të gjurmuar në vitin 2025 janë shprehur se ndjeheshin të "kënaqur" ose "shumë të kënaqur" dhe 11% kanë shprehur se ndjeheshin të "pakënaqur" dhe "shumë të pakënaqur".

Tabela 5: Perceptimet për sigurinë dhe kënaqësinë në punën aktuale (2018-2025)


	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	5%	7%	6%	3%	5%	4%	8%	**11%**
I/e pasigurt	14%	16%	3%	5%	4%	6%	3%	**2%**
Neutral	48%	16%	31%	26%	21%	13%	15%	**13%**
I/e sigurt	29%	41%	31%	32%	44%	58%	53%	**28%**
Shumë i/e sigurt	5%	20%	29%	34%	27%	20%	23%	**46%**
Shumë i/e pakënaqur	0%	3%	9%	3%	1%	4%	10%	**9%**
I/e pakënaqur	10%	14%	4%	3%	10%	3%	0%	**2%**
Neutral	62%	11%	15%	18%	23%	13%	18%	**11%**
I/e kënaqur	29%	50%	41%	45%	46%	61%	55%	**30%**
Shumë i/e kënaqur	0%	21%	31%	32%	20%	20%	18%	**48%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=21); **2019** (N=70); **2020** (N=80); **2021** (N=38); **2022** (N=82); **2023** (N=71), **2024** (N=40), **2025** (N=46).

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 87% e të diplomuarve në vitin 2025 u përgjigjën se kanë arritur të gjejnë punë para diplomimit dhe 4% 1 muaj pas diplomimit. Ndërkohë, përkatësisht 2% e kanë gjetur punën 3 – 6 muaj pas diplomimit, 4% 6 - 9 muaj pas diplomimit dhe 2% kanë arritur të gjejnë punë 9 – 12 muaj pas diplomimit.

Figura 20: Periudha kohore në kërkim të një pune (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=46

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	**2026**
Para diplomimit	47%	66%	49%	81%	56%	65%	55%	87%
1 muaj pas diplomimit	7%	7%	12%	5%	13%	12%	15%	4%
1 - 3 muaj pas diplomimit	3%	12%	14%	7%	8%	7%	10%	0%
3 - 6 muaj pas diplomimit	30%	4%	6%	2%	8%	10%	10%	2%
6 - 9 muaj pas diplomimit	3%	6%	9%	5%	9%	3%	8%	4%
9 - 12 muaj pas diplomimit	10%	5%	9%	0%	7%	3%	3%	2%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=30); **2019** (N=83); **2020** (N=85); **2021** (N=43); **2022** (N=91); **2023** (N=69), **2024** (N=40), **2025** (N=46).

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, vërehet se për të tetë brezat e gjurmuar, mënyra mbizotëruese e gjetjes së punës së parë është nga njohjet, lidhjet familjare dhe miqtë. Përkatësisht, 50% e të diplomuarve gjatë vitit 2025, pohojnë se kanë gjetur punë nga njohjet personale, me një rënie prej 6 pikësh përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (56%). Ndërkohë, 17% pohojnë se e kanë gjetur punën nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazeta me një rritje prej 10 pikësh përqindje nga mesatarja 2018-2024 (27%). Gjithashtu 20% pohojnë që kanë gjetur punën nga praktika profesionale në biznes me një rritje prej 17 pikësh përqindje nga mesatarja 2018-2024 (3%).

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2018-2025)

	2018	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**	2024	**2025**
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	24%	33%	24%	29%	21%	31%	24%	**17%**
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	71%	51%	51%	61%	62%	44%	49%	**50%**
Nga praktika profesionalë në biznes	0%	1%	3%	0%	5%	7%	2%	**20%**
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdhënësin tim	5%	14%	18%	8%	10%	7%	12%	**7%**
Nga mësuesit	0%	0%	0%	0%	2%	4%	0%	
Nga Zyra e Punësimit	0%	0%	1%	0%	0%	3%	0%	
Nga qendra e karrierës/ njësia e zhvillimit në shkollë	0%	0%	0%	0%	0%	1%	10%	**2%**
Tjetër	0%	0%	4%	3%	0%	3%	2%	**4%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=30); **2019** (N=83); **2020** (N=85); **2021** (N=43); **2022** (N=91); **2023** (N=74), **2024** (N=41), **2025** (N=46).

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 8), në vitin 2025, 47% pohuan se shkolla i ka mësuar se si të aplikojnë për punë (vërehet rritje me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024, 41%), 36% pohuan se i ka

ndihmuar në orientimin mbi mundësitë e ndryshme për punësim (vërehet rritje me 2 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024, 34%). Gjithashtu, një numër i madh të atyre që pohojnë se përgjithësisht shkolla nuk i ka ndihmuar në gjetjen e punës së parë. Kështu, në vitin 2025, 17% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se shkolla përgjithësisht nuk i ka ndihmuar. Megjithatë, në këtë aspekt kemi një rënie me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024, 27%).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2018-2025)


	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	59%	37%	33%	48%	33%	38%	38%	**47%**
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	59%	43%	25%	14%	27%	30%	40%	**36%**
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdhënës potencialë	45%	34%	4%	5%	18%	18%	21%	**17%**
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	21%	22%	44%	31%	32%	24%	17%	**17%**
Tjetër	0%	1%	3%	5%	6%	5%	9%	**4%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=29); **2019** (N=94); **2020** (N=91); **2021** (N=42); **2022** (N=90); **2023** (N=74), **2024** (N=47), **2025** (N=53).

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Për vitin 2025, 23% e të diplomuarve të gjurmuar pohojnë se janë të punësuar por edhe studiojnë në të njëjtën kohë. Kjo mesatare për vitet 2018 - 2024 ka qenë 20%. Në këtë aspekt kemi një rritje me 3 pikë përqindje të të diplomuarve të cilët punojnë dhe studiojnë në të njëjtën kohë. Ndërkohë, 20% e të diplomuarve të gjurmuar për vitin 2025 shprehen se janë student/kursant. Këtu vërehet një ulje me 10 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018 - 2024 e cila ka qenë 30%.


Figura 21: Ndjekja e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=114); **2019** (N=180); **2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=__).

Sikurse në vitet paraardhëse, pjesa më e madhe e të diplomuarve në 2025 që ndjekin kualifikime të mëtejshme kanë zgjedhur universitetin 94% dhe vetëm 6% , studiojnë pranë një shkolle profesionale pas të mesmes.


Figura 22: Llojet e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018 (**N=72); **2019** (N=100); **2020** (N=77); **2021** (N=43); **2022** (N=73); **2023** (N=14), **2024** (N=30), **2025** (N=17).

Nga të diplomuarit që ndjekin studime të mëtejshme, 76% studiojnë në institucione publike dhe 24% në ato private. Mesatarisht, 2020-2024 ka qenë 64% e të diplomuarve të cilët ndjekin studimet të mëtejshme studiojnë në institucione publike dhe 36% në ato private.


Figura 23: Lloji i institucionit (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=77); **2021** (N=43); **2022** (N=73); **2023** (N=14), **2024** (N=30), **2025** (N=17).

Ndërkohë, të pyetur nëse studimet/trajnimet që po ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë (shiko figurën 24), 76% e të gjurmuarve që studiojnë janë shprehur se fusha e studimeve që po ndjekin tani lidhet me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 24% të cilët shprehen se studimet e mëtejshme nuk lidhen me shkollën që kanë bërë. Nga viti 2020 deri në 2025 mesatarisht 84% e të gjurmuarve u shprehën se studimet/trajnimet që ndjekin lidhen me shkollën që kanë bërë, përkundrejt 16% të cilët pohojnë se nuk lidhen.

Figura 24: Lidhja e studimeve me profesionin (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=77); **2021** (N=43); **2022** (N=73); **2023** (N=14), **2024** (N=30), **2025** (N=17).

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), 59% e të diplomuarve në 2025 janë përgjigjur për të fituar një kualifikim më të lartë (46% mesatarja e viteve 2018-2024); 24% për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë (33% mesatarja e viteve 2018-2024); dhe 18% për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale (17% mesatarja e viteve 2018-2024).

Tabela 9: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2018-2025)


	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	36%	29%	62%	35%	52%	71%	37%	**59%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	39%	56%	19%	56%	26%	14%	23%	**24%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	14%	13%	14%	7%	21%	14%	37%	**18%**
Nuk gjeta dot punë	10%	1%	3%	0%	0%	0%	3%	**0%**
Tjetër	1%	0%	1%	2%	1%	0%	0%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2018** (N=72); **2019** (N=68); **2020** (N=77); **2021** (N=43); **2022** (N=73); **2023** (N=14), **2024** (N=30), **2025** (N=17).

Të diplomuarit pa punë

Në vitin 2025, 19% e të diplomuarve të gjurmuar janë të papunë një vit pas diplomimit (figura 25). Mesatarisht, gjatë 2018-2024, 17% e të diplomuarve kanë qenë të papunë. Në këtë kontekst, vërehet një rritje e papunësisë për vitin 2025 me 2 pikë përqindje.


Figura 25: Papunësia ndër vite (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2018** (N=114); **2019** (N=180); **2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=86).

Të pyetur nëse po kërkonin punë, 56% të diplomuarve të papunë të vitit 2025 u përgjigjën që po kërkonin për punë. Ndërsa 44% e të diplomuarve të papunë u shprehën se nuk po kërkonin për punë.

Figura 26: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2020-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=24); **2021** (N=13); **2022** (N=23); **2023** (N=20), **2024** (N=18), **2025** (N=7).

Një vlerësim krahasues me vitet e kaluara (shiko tabelën 10), nxjerr në pah se arsyet më madhore që mendohet se sjellin pamundësinë për të gjetur një punë janë: (i) mospërputhja e ofertës për punë me arsimin (43% në 2025, 10% në vitet 2018-2024), (ii) mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura për të gjetur një punë (43% në vitin 2025, 24% në vitet 2018-2024). Një arsye tjetër është mungesa e punës në qarkun e tyre (14% në 2025, 8% në vitet 2018-2024).

Tabela 10: Arsyet kryesore të papunësisë (2018-2025)


	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025

Më mungon eksperienca e punës	0%	19%	57%	33%	38%	53%	44%	**0%**
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	0%	0%	0%	11%	8%	0%	0%	**0%**
Ofertat për punë nuk lidhen me arsimimin tim	17%	6%	7%	11%	8%	7%	11%	**43%**
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	25%	16%	21%	33%	31%	20%	22%	**43%**
Nuk ka punë në qarkun tim	33%	6%	7%	0%	8%	0%	0%	**14%**
Jam i/e angazhuar në punë familjare	0%	6%	0%	0%	0%	7%	0%	**0%**
Tjetër	25%	6%	7%	11%	8%	13%	22%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2018** (N=12); **2019** (N=31); **2020** (N=14); **2021** (N=9); **2022** (N=13); **2023** (N=15), **2024** (N=9), **2025** (N=7).

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 27), 78% e të diplomuarve në vitin 2025, 67% e tyre përmendin si metodë kryesore njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazeta etj dhe 56% duke kontaktuar drejtpërdrejtë me bizneset (duke dërguar CV). Ndërkohë, 11% e të diplomuarve të papunë të cilët janë në kërkim të një pune, e kërkojnë atë nëpërmjet shkollës. Numri i të diplomuarve që pohojnë se e kërkojnë punën përmes zyrave të punës për vitin 2025 është 0.

Figura 27: Metodat e kërkimit për punë (2020-2025)



***Shënim**: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=14); **2021** (N=9); **2022** (N=13); **2023** (N=15), **2024** (N=9), **2025** (N=7).*

Më tej, të diplomuarit e papunë të cilët nuk ishin në kërkim të një pune u pyetën për arsyet e mos kërkimit të punës (shiko tabelën 11). 3 nga 7 të diplomuarit e papunë të cilët nuk po kërkonin punë u

shprehen se nuk kishin dëshirë të punonin për momentin. Ndërkohë, 3 nga 7 të diplomuarit u shprehën se kanë plan të largohen

nga vendi. Për vitin 2025, vetëm një nga të diplomuarit e gjurmuar të cilët nuk po kërkonin punë u shpreh se kujdesej për fëmijët/ familjen. Ndërsa asnjë nuk kishte besim se do të gjente punë ose që priste të fillonte punë së shpejti.


Tabela 11: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2020-2025)

	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Po pres të filloj punë së shpejti	10%	25%	10%	40%	22%	**0%**
Nuk kam besim se do të gjej punë	10%	0%	10%	0%	0%	**0%**
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	40%	75%	30%	60%	33%	**43%**
Kam në plan të largohem nga vendi	40%	0%	50%	0%	11%	**43%**
Kujdesem për fëmijët/ familjen dhe prindërit	0%	0%	0%	0%	0%	**14%**
Tjetër	0%	0%	0%	0%	33%	**0%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2020** (N=10); **2021** (N=4); **2022** (N=10); **2023** (N=5), **2024** (N=9) , **2025** (N=7) .

Për vitin 2024, 44% e të diplomuarve të papunë kanë qenë më herë në marrëdhënie pune. Në këtë aspekt vërehet një rritje me 5 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë.

Figura 28: Niveli i të diplomuarve të papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2018** (N=12); **2019** (N=31); **2020** (N=24); **2021** (N=13); **2022** (N=23); **2023** (N=20), **2024** (N=18), **2025** (N=__).

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla me qëllim përgatitjen më të mirë të nxënësve për tregun e punës, të gjurmuarit pohuan se të gjitha aspektet e shkollës të paraqitura në tabelën 12 kanë "shumë/jashtëzakonisht shumë" nevojë për përmirësim. Theksi këtë vit është tek nevoja për përmirësim praktikave në biznes 67% (me një rritje prej 14 pikë përqindje me mesataren e viteve 2018-2024 (53%), përmirësim të bashkëpunimi me bizneset, 63% (me një rritje me 11 pikë përqindje krahasuar me mesataren e viteve 2018-2024 (52%). Për më tepër, kërkohet përmirësimi i këshillimit në karrierë (60%), bashkëpunimi me zyrat e punës (60%) dhe praktika në shkollë (53%).


Tabela 12: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkollë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Infrastruktura	31%	27%	47%	27%	38%	42%	34%	**49%**
Kurrikula	38%	28%	53%	35%	43%	47%	37%	**43%**
Tekstet dhe materialet	31%	28%	56%	37%	45%	48%	42%	**52%**
Metodat e mësimdhënies	38%	33%	51%	33%	49%	48%	49%	**44%**
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	21%	35%	52%	26%	47%	47%	39%	**44%**
Praktika në shkollë	28%	37%	64%	48%	64%	65%	55%	**53%**
Praktika në biznes	28%	44%	69%	42%	66%	63%	59%	**67%**
Këshillimi i karrierës	31%	44%	62%	34%	60%	60%	55%	**60%**
Bashkëpunimi me bizneset	28%	50%	70%	41%	61%	60%	57%	**63%**
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	24%	56%	65%	38%	65%	64%	53%	**60%**

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2018** (N=29); **2019** (N=94); **2020** (N=146); **2021** (N=71); **2022** (N=130); **2023** (N=99), **2024** (N=76), **2025** (N=71).

Nëse do të kishin mundësi, 87% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë dhe 93% të njëjtën shkollë (shiko figurën 29). Mesatarisht, përgjatë viteve 2018-2024, 82% e të diplomuarve do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe po 83% do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë. Në këtë aspekt, për vitin 2024 vërehet një rritje me përkatësisht 4 dhe 11 pikë përqindje në përzgjedhjen e së njëjtës degë dhe të së njëjtës shkollë.

Figura 29: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2018-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2018** (N=114); **2019** (N=180); **2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=86).

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë paraqitet në tabelën 13. Për vitin 2024, 93% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 90% të njëjtën shkollë. Ndërkohë, 100% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 87% të njëjtën shkollë. Nga ana tjetër i vetmi i diplomuar ne Administrim Zyre do të përzgjidhte sërish si të njëjtën degë po ashtu të njëjtën shkollë. Nga ana tjetër nga 3 të diplomuarit në Sipërmarrje e Agjencisë Turistike të gjithë do të zgjidhnin të njëjtën degë dhe 2 do të sërish të njëjtën shkollë. Mesatarisht, gjatë viteve 2018-2024, 83% e të diplomuarve në Ekonomi-Biznes do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 84% të njëjtën shkollë. Ndërkohë, mesatarisht gjatë viteve 2018-2024, 84% e të diplomuarve në Tekstil-Konfeksione do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 77% të njëjtën shkollë.

Tabela 13: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2018-2025)


		Ekonomi-Biznes	Tekstil-Konfeksione	Administrim Zyre	Sipërmarrje e agjencisë turistike
2018	Degë	78%	75%		
	Shkollë	80%	75%		
2019	Degë	89%	78%		
	Shkollë	94%	100%		
2020	Degë	80%	62%		
	Shkollë	81%	69%		
2021	Degë	81%	83%		
	Shkollë	74%	50%		
2022	Degë	81%	85%		

	Shkollë	86%	85%		
2023	Degë	81%	60%		
	Shkollë	81%	60%		
2024	Degë	90%	100%		
	Shkollë	92%	100%		
2025	**Degë**	**93%**	**100%**	**100%**	**67%**
	Shkollë	**90%**	**87%**	**100%**	**33%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2018**: N_{EB}=110, N_{TK}=4; **Baza 2019**: N_{EB}=171, N_{TK}=9; **Baza 2020**: N_{EB}=139, N_{TK}=13; **Baza 2021**: N_{EB}=68, N_{TK}=12; **Baza 2022:** N_{EB}=136, N_{TK}=13; **Baza 2023:** N_{EB}=98, N_{TK}=10, **Baza 2024:** N_{EB}=74, N_{TK}=1, **Baza 2025:** N_{EB}=67, N_{TK}=15, N_{AZ}=1, N_{SAT}=3

Të disagreguara sipas gjinisë përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe së njëjtës shkollë jepet në figurën 30. Sikurse tregohet edhe në figurë, 95% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore do të përzgjidhnin të njëjtën shkollë dhe të njëjtën degë. Ndërkohë 82% e të diplomuarave të gjinisë femërore do të përzgjidhnin të njëjtën degë dhe 92% të njëjtën shkollë.

Figura 30: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe e së njëjtës shkollë sipas gjinisë 2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N_M=37; N_F=49

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet që kanë të diplomuarit për të ardhmen e tyre të afërt në aspektin profesional dhe të kualifikimeve të mëtejshme (shiko tabelën 14), 51% e të diplomuarve në vitin 2025 shpresojnë të kenë filluar një biznes të tyre. Këtu, vërehet një rritje me 8 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (34%). Ndërkohë, 35% kanë pohuar se kanë dëshirë të kenë gjetur një punë që të lidhet me fushën e tyre të studimit. Mesatarisht, 2018-2024, 47% e të diplomuarve kanë shprehur dëshirën për të gjetur një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit duke vënë re një rënie me 8 pikë përqindje.

Për më tepër 21% e të diplomuarve në vitin 2025 pohojnë se kanë dëshirë të ndjekin studime të mëtejshme. Këtu vërehet një rënie me 6 pikë përqindje nga mesatarja e viteve 2018-2024 (27%).

Ndërkohë, për vitin 2025, vërehet një ulje prej 7 pikë përqindje e të diplomuarve të cilët dëshirojnë të kenë emigruar jashtë vendit (19% mesatarja 2018-2024).

Tabela 14: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2018-2025)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Të jem punësuar	21%	13%	7%	10%	15%	23%	15%	**23%**
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	53%	52%	50%	48%	46%	41%	37%	**35%**
Të kem filluar biznesin tim	20%	23%	39%	33%	44%	40%	41%	**51%**
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	11%	36%	26%	26%	36%	22%	28%	**21%**
Të kem emigruar jashtë vendit	25%	22%	24%	24%	11%	9%	14%	**12%**
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	1%	0%	1%	0%	1%	0%	3%	**0%**
Tjetër	2%	3%	4%	6%	3%	2%	3%	**1%**

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2018** (N=114); **2019** (N=180); **2020** (N=152); **2021** (N=80); **2022** (N=149); **2023** (N=108), **2024** (N=81), **2025** (N=86).

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit të gjurmimit për Shkollën Teknike Ekonomike Tiranë. Për brezin 2025 janë gjurmuar 86 nga 116 të diplomuarit. Rezultatet për drejtimet me pak të anketuar duhen interpretuar me kujdes, ndërsa mospërputhjet në raport kërkojnë verifikim para përdorimit në planifikim.

1. Praktikë më e lidhur me mundësitë e punësimit në profesion

Planet e praktikës të rishikohen me bizneset dhe të diplomuarit, duke identifikuar aftësitë dhe detyrat që ndihmojnë hyrjen në profesion. Të ndiqen mundësitë e punësimit në bizneset pritëse pas përfundimit të praktikës.

Gjetja: Përmirësimin e praktikës në biznes e kërkojnë 67% e të diplomuarve që iu përgjigjën pyetjes, ndërsa bashkëpunimin me bizneset 63% (N=71). Vetëm 47% raportojnë se puna lidhet me arsimin e tyre (N=53). Ndërkohë, 20% e kanë gjetur punën e parë përmes praktikës në biznes (N=46).

2. Orientim në karrierë me ndërmjetësim konkret

Mbështetja për kërkimin dhe aplikimin për punë të shoqërohet me takime me punëdhënës, shpërndarje vendesh të lira dhe referime te zyra e punësimit. Shkolla të ndjekë rezultatet e këtyre kontakteve pas diplomimit.

Gjetja: Vetëm 17% raportojnë se shkolla i ka ndihmuar të vendosin kontakte me punëdhënës, ndërsa 36% se i ka orientuar mbi mundësitë e punësimit (N=53). Punën e parë e kanë gjetur 50% përmes lidhjeve personale dhe vetëm 2% përmes qendrës së karrierës ose Njësisë së Zhvillimit. Përmirësimin e këshillimit në karrierë dhe bashkëpunimit me zyrat e punësimit e kërkojnë nga 60%.

3. Mbështetje e përshtatur për vajzat dhe profilin Tekstil-Konfeksion

Të kontaktohen të diplomuarit pa punë për të kuptuar pengesat individuale dhe nevojat për këshillim, ndërmjetësim ose trajnim plotësues. Për Tekstil-Konfeksionin të diskutohen me bizneset mundësitë e punësimit dhe arsyet e punësimit jashtë profesionit.

Gjetja: Pa punë janë 16 nga 86 të diplomuarit. Papunësia raportohet nga 22% e vajzave dhe 14% e djemve. Në Tekstil-Konfeksion, 33% janë pa punë (N=15), ndërsa vetëm 14% e të punësuarve me përgjigje të vlefshme deklarojnë se puna lidhet me arsimin (N=7). Baza e vogël kërkon diskutim individual përpara përgjithësimit.

4. Më shumë informacion për kushtet e punës

Në orientimin në karrierë të përfshihen sesione praktike për kontratat, kushtet e punës dhe verifikimin e sigurimeve. Të diplomuarit që raportojnë punësim pa kontratë ose pasiguri të orientohen drejt shërbimeve përkatëse.

Gjetja: Në 2025, 24% e të punësuarve me përgjigje të vlefshme raportojnë se nuk kanë kontratë pune. Gjithashtu, 11% ndihen shumë të pasigurt dhe 2% të pasigurt në punën aktuale (N=46).

5. Mbështetje praktike për interesin për sipërmarrje

Të diplomuarve që synojnë të hapin një biznes t'u ofrohet këshillim fillestar për zhvillimin e idesë, vlerësimin e tregut dhe planifikimin financiar. Të krijohen kontakte me sipërmarrës dhe shërbime mbështetëse sipas fushës së interesit.

Gjetja: Në 2025, 51% dëshirojnë të kenë filluar biznesin e tyre brenda dy viteve, ndërsa vetëm 8% janë aktualisht të vetëpunësuar (N=86). Ky dallim kërkon sqarimin e gatishmërisë dhe të mbështetjes që u nevojitet për ta konkretizuar interesin.